REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA POGRADEC**
**KESHILLI**

Nr. 2269/6 Prot. Pogradec, më 21.05.2026

Lënda: Dërgohet material për shqyrtim dhe miratim

**KRYETAR I KESHILLIT BASHKIAK**

**E nderuar znj Kryetare,**

Bashkegjitur po ju dergojme per shqyrtim dhe miratim Projekt Vendimin per:

**PËR NJE NDRYSHIM NE VKB NR 128 DT 22.12.2025" MIRATIMIN DHE DETAJIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË POGRADEC PËR VITIN 2026", (NUMRI I PUNONJESVE)**

Me respekt,

**K R Y E T A R I**

**Ilir XHAKOLLI**

Nr. i faqeve A4 të projekt-vendimit: ____

Nr. i faqeve A4 të relacioni shoqërues: ____

Nr. i i fletëve të dokumenteve që shoqërojnë projekt vendimin: ____

Bulevardi "Rreshit Çollaku", Lagja: Nr.2, Tel: +355 (83) 222222, Fax: +355 (83) 222441, E-mail: bashkiapogradec@gmail.com

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA POGRADEC**
**KESHILLI**

Nr. ______Prot.　　　　　　　　　　　　　　　　Pogradec, më ____.___.2026

## PROJEKT-VENDIM

**NR.______,DATË____.____.2026**

**PËR NJE NDRYSHIM NE VKB NR 128 DT 22.12.2025**

**" MIRATIMIN DHE DETAJIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË POGRADEC PËR VITIN 2026", (NUMRI I PUNONJESVE)**

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 "Per Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar; Ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" i ndryshuar, Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, "Per menaxhimin e sistemit buxhetor te Republikes te Shqiperise", i ndryshuar, Udhezimit te Ministrise se Financave nr. 2, date 14.01.2026 , "Per zbatimin e buxhetit 2026, , VKB 128 dt 22.12.2025 "Miratimin dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Pogradec për vitin 2026 " Këshilli Bashkiak :

## VENDOSI:

1. Të miratojë ndryshimin e pikes 3 të VKB nr.128 dt 22.12.2025 për numrin e punonjësve të Bashkisë Pogradec si më poshtë:

**Ishte**

Te miratoje numrin e punonjesve per vitin **2026 propozohet të jetë 820 punonjës** dhe alokimi si më poshtë:

1. Bashkia Qëndër, Njësitë Adminstrative dhe MZSH　**248 punonjës**
2. Qëndra Arsimore　**257 punonjës**
3. Ndërmarrja e Mirëmbajtjes së Infrastrukturave dhe Punëve Publike　**140 punonjës**

4. Ndërmarrja e Parqeve dhe Rekreacionit **85 punonjës**

5. Agjensia e Mbrojtjes se Teritorrit **75 punonjes**

Numri i punonjësve me kontratë shërbimi të përkohshme në Bashkinë Pogradec për vitin **2026** është menduar të jetë, **15 (pesembedhjetë), mbi numrin e përgjithshëm (805 punonjës).**

**Bëhet**

Te miratoje numrin e punonjesve per vitin **2026 propozohet të jetë 840 punonjës** dhe alokimi si më poshtë:

| | |
|---|---|
| 1. Bashkia Qëndër, Njësitë Adminstrative dhe MZSH | **248 punonjës** |
| 2. Qëndra Arsimore | **267 punonjës** |
| 3. Ndërmarrja e Mirëmbajtjes së Infrastrukturave dhe Punëve Publike | **140 punonjës** |
| 4. Ndërmarrja e Parqeve dhe Rekreacionit | **85 punonjës** |
| 5. Agjensia e Mbrojtjes se Teritorrit | **75 punonjes** |

Numri i punonjësve me kontratë shërbimi të përkohshme në Bashkinë Pogradec për vitin **2026** është menduar të jetë, **25 (njezet e pesë), mbi numrin e përgjithshëm (815 punonjës).**

2. Per zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Drejtoria e Ekonomisë dhe Menaxhimit Financiar dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore te Bashkise Pogradec.

3. Ky Vendim hyn ne fuqi 10 dite mbas shpalljes.

**KRYETAR**

**Manjola KAMOLLI**

Bulevardi "Rreshit Çollaku", Lagja: Nr.2, Tel: +355 (83) 222222, Fax: +355 (83) 222441, E-mail: bashkiapogradec@gmail.com

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA POGRADEC**
**DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

# RELACION

## PËR SHTIM NUMRI TË PERSONELIT NË ORGANIKËN DHE STRUKTURËN E BASHKISË POGRADEC DHE NDËRMARRJEVE NË VARËSI PËR VITIN 2026

**E nderuar Znj. Kryetare i Këshillit Bashkiak,**

**Të nderuar Këshilltarë,**

Projekt - Vendimi që po ju paraqesim bazohet në nenin 54 të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen", i ndryshuar, si dhe në zbatim të Vendimit nr. 893, datë 17.12.2024 "Për miratimin e rregullave të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore, si dhe për procedurat e hollësishme për përgatitjen, propozimin, konsultimin dhe miratimin i organizimit", Strukturën e miratuar me Vendim nr.20, datë 22.01.2026, "Për Miratimin e Strukturës, Organikës dhe Kategorizimit të Pozicioneve të Punës të Bashkisë Pogradec, Njësive Administrative dhe Institucioneve në Varësi për vitin 2026" si dhe me vendimin nr. 128, datë 22.12.2025 "Për miratimin dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Pogradec për vitin 2026" kemi miratuar numrin e përgjithshëm të punonjësve të Bashkisë dhe Ndërmarrjeve në varësi të saj me një numër total prej **805 punonjës** si më poshtë vijon;

1. Bashkia Qendër, Njësitë Administrative dhe MZSH **248 punonjës**
2. Qendra Arsimore **257 punonjës**
3. Ndërmarrja e Mirëmbajtjes së Infrastrukturave dhe Punëve Publike **140 punonjës**
4. Ndërmarrja e Parqeve dhe Rekreacionit **85 punonjës**
5. Agjencia e Mbrojtjes së Territorit **75 punonjës**

Në këtë projekt vendim që po ju paraqesim kërkojmë shtimin e personelit konkretisht:

Numri i punonjësve të Qëndrës Arsimore të miratuar për vitin 2026, nga 257 ( Dyqind e pesëdhjetë e shtatë) punonjës, të rriten në 267 ( Dyqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) punonjës, konkretisht me 10 punonjës;

[1]Bulevardi "Rreshit Çollaku", Lagja: Nr.2, Tel: +355 (83) 222222, Fax: +355 (83) 222441, E-mail: bashkiapogradec@gmail.com

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## BASHKIA POGRADEC

### DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Numri i punonjësve me kontratë të përkohshme në Bashkinë Pogradec, është miratuar 15 (pesembëdhjetë), mbi numrin e përgjithshëm, të rritet në 25 ( Njëzet e pesë), konkretisht në 10 punonjës, mbi numrin e përgjithshëm, **815 puonjës**

Projekt – Vendimi lidhet me dy nevoja konkrete:

1- **Funksionimin normal dhe të sigurt të sistemit parashkollor, në kuadër të hapjes dhe vënies në funksion të Çerdhes së re.**
2- **Garantimin e sigurisë publike në plazhe si dhe në mirëmbajtjen dhe forcimin e kapaciteteve të Bashkisë Pogradec, nëpërmjet shtimit të pozicioneve të përkohshme.**

Shtimi personelit nuk përbën thjesht rritje numerike të organikës, por është një masë organizative e domosdoshme për të garantuar funksionin efektiv, siguri, cilësi shërbimi dhe përgjegjshmëri institucionale;

Rritja e numrit të punonjësve do të mundësojë funksionimin e plotë të institucionit parashkollor, përmirësimin e standarteve të kujdesit ndaj fëmijëve, rritjen e sigurisë gjatë sezonit turistik dhe forcimin e kapaciteteve të Bashkisë Pogradec në ofrimin e shërbimeve publike.

Ju Faleminderit ,

Nga:

**DREJTORIA E BURIMEVE NJEREZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

**Konceptoi: Laura Elmasllari**

**Miratoi: Irsa Karapança**

**Konfirmoi: Alma Kanina**

**KRYETAR**

**Ilir XHAKOLLI**

[1]Bulevardi "Rreshit Çollaku", Lagja: Nr.2, Tel: +355 (83) 222222, Fax: +355 (83) 222441, E-mail: bashkiapogradec@gmail.com